



Viti i IX-të i Botimit, Nr.2,  
Dhjetor 2018

# FORMIMI AKADEMIK I STUDENTËVE NËN NDIKIMIN E SJELLJEVE TË PANDERSHME

**Drilona Llangos**

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

*Adresë kontakti:* drilona.llangos@gmail.com

## **Përmbledhje**

Formimi i përgjithshëm i njeriut fillon që në bankat e para të shkollës dhe vazhdon gjatë gjithë periudhës së studimeve. Evidentohet se vitet e studimit të shkollës së lartë janë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm që aktivizojnë sjelljet mashtruese. Ndër këta faktorë përmendim presionin shoqëror për sukses, perceptimin që të gjithë mashtrojnë, sfondi social, familjar etj. Sfidat e edukimit në vitet e fundit përqendrohen kryesisht në luftimin dhe uljen e pandershmërisë akademike si fenomen shqetësues për arsimin dhe rininë studentore; si problematikë që ndikon të ardhmen e profesionistëve të rinj, dhe si pasojë, edhe në ardhmërinë e funksionimit efikas të shërbimeve publike.

Në këtë punim, si qëllim kryesor është zbulimi i formave tipike të mashtrimit që angazhohen studentët dhe ndikimi që ato kanë.

Për realizimin e studimit u administrua një pyetësor i strukturuar në një kampion prej 135 studentësh, përkatësisht 95 të Albania University, 40 të Universitetit Evropian të Tiranës, të nivelit baçelor dhe master. Pyetësori u ndërtua nga Prof. Dr. Nikoleta Mita, bazuar në studimin e literaturës.

Ndër rezultatet paraprake u evidentua një numër i konsiderueshëm i rasteve të mashtrimit akademik te studentët në të dy universitetet, si dhe shfaqja e formave të reja të mashtrimit, si: plagjiatura dhe kopjimi nga interneti.

**Fjalë çelës:** *mashtrim akademik, edukim, frekuenca, plagjiatura, kopje.*

## ACADEMIC FORMATION OF STUDENTS UNDER THE INFLUENCE OF DISHONEST BEHAVIOR

### Abstract

The general elaboration of human begins in elementary school and continues throughout the period of studies. It is evident that study years at university are under the influence of various factors that activate cheating behaviours. Among these factors we mention the social pressure for success, the perception that everyone is cheating, social background, family, etc. Education challenges in recent years focus mainly on combating and reducing academic dishonesty as a worrying phenomenon for education and student youth; as issues affecting the future of young professionals and as a consequence for the future of the efficient functioning of public services.

The main purpose in this paper is to discover the typical forms of cheating that students engage and the impact they have.

For the realization of the study a structured questionnaire was administered in a sample of 135 students; respectively 95 of Albania University, 40 of the European University of Tirana; bachelor and master level. The questionnaire was constructed by Prof. Dr. Nikoleta Mita, based on the study of literature.

Among the preliminary results, a considerable number of cases of academic fraud were identified among students at both universities; as well as the emerge of new forms of cheat like plagiarism and copying from the internet.

**Key words:** *academic cheating, education, frequency, plagiarism, copy.*

### Hyrje

Me gjithë përpjekjet për edukimin e karakterit në ciklet shkollore, forcimin e integritetit dhe strategjive të ndërmarrë, vitet e fundit janë evidentuar në masë të studentët forma të mashtrimit akademik. Mullens (1) e përkufizon pandershmerinë akademike si çdo gjë që i jep një studentit përparësi të pafituar mbi një tjetër. Ai përfshin: blerjen e një eseje, plagjiaturën e paragrafëve apo tekste të tëra, mbushje të bibliografisë, bashkëpunim në një detyrë kur profesori kërkon punë individuale etj. Trenholm (2) thekson se mashtrimi (kopjimi, plagjiatura, keqpërdorimi i

identitetit dhe bashkëpunimi jo i përshtatshëm) është sjellja në të cilën parimi etik që dhunohet, është integriteti akademik. Mashtrimi është një formë e pandershmërisë akademike dhe studimet reflektojnë një shqetësim të thellë në lidhje me shkeljet në sjelljen etike akademike. Studentët janë bërë të vetëdijshëm për përcaktimin e integritetit akademik, pse integriteti akademik është i rëndësishëm, si dhe për dallimin midis plagjiaturës dhe mashtrimit (3). Sjellja jo etike ndodh në shumë kolegje dhe universitete ku studentët e pandershëm dhe veprimet e tyre me sukses prishin mjedisin e të mësuarit (4). Në këtë punim do tentohet të zbulohet perceptimi i studentëve dhe i formave tipike të mashtrimit që angazhohen studentët e përzgjedhur, dhe ndikimi që ato kanë.

## METODOLOGJIA

### Instrumentet

Për realizimin e këtij studimi si instrument kryesor është përdorur pyetësi i strukturuar dhe studimi i literaturës. Në fillim pyetësi iu nënshtrua një faze pilotimi paraprak.

**Kampionimi:** Pyetësi u administrua te 135 studentë (baçelor dhe master) në 2 universitete private në Shqipëri (kampioni është një porcion i kampionit prej 1105 studentësh të përzgjedhur në studimin e doktoraturës, prej të cilit rrjedh ky studim i vogël mbi mashtrimin akademik te studentët e universiteteve private). Procedura për përzgjedhjen e kampionit ka qenë me kuotim në bazë të numrit të përgjithshëm të studentëve në universitet.

## REZULTATET DHE DISKUTIMI

Pandershmëria akademike është një shkelje e rregullave dhe rregulloreve të pothuajse çdo institucioni. Si pjesë e detyrës së tyre, institucionet parashikojnë që anëtarët e fakultetit, përmes programeve mësimore të tyre dhe procesit mësimor të punës së tyre individuale, të sigurojnë që studentët të përkrahin integritetin akademik (5).

Për të trajtuar problemin e pandershmërisë akademike në universitetet, është e domosdoshme të bëhen studime në lidhje me perceptimet dhe shkaqet e sjelljeve të tilla. Studimi i studentëve të diplomuar, perceptimet e tyre, si dhe normat e frekuencave të sjelljeve pandershme janë të rëndësishme për shumë arsye (6).

Përparimet teknologjike në ditët e sotme e ka bërë pandershmërinë akademike më të lehtë për t'u kryer dhe më të vështirë për t'u identifikuar nga fakulteti, sipas Johnson dhe Martin (2005). Mashtruesit janë duke përdorur teknologji që të minojnë integritetin akademik dhe studentët janë duke u bërë inovativë në metodat e tyre mashtruese. Studentët tani janë duke përdorur telefonat celularë për të marrë informacionin e provimit, të komunikojnë me të tjerët jashtë sallës së provimit për të marrë përgjigje dhe të kërkojnë për përgjigje në ueb gjatë një provimi, dhe teknika të tilla janë duke paraqitur një sfidë të re për edukatorët e sotëm (5).

### Perceptimi i pandershmërisë akademike te studentët e Albania University dhe Universitetit Evropian të Tiranës

Në tabelën më poshtë paraqitet perceptimi i studentëve të dy universiteteve në lidhje me fenomenin e pandershmërisë akademike.

Duke analizuar perceptimin e tyre do të mundemi të japim një shpjegim në lidhje me frekuencën e formave të pandershmërisë akademike në të cilat studentët përfshihen.

**Tabela 1. Perceptimi i pandershmërisë akademike në AU dhe UET**

<u>AU – 95 dhe UET – 40</u>	S'jam dakord	Pjesërisht dakord	Dakord	Plotësisht dakord
a. Integritet akademik do të thotë të mbash përgjegjësi për zbatimin e etikës akademike dhe të mos e shkelësh atë në asnjë rast.	2.1% - 0	20% - 25%	49.5% - 52.5%	28.4% - 22.5%
b. Marrja e vendimeve personale sipas etikës akademike është pjesë e integritetit akademik.	10.5 – 10	34.7 - 25	41.1 - 40	13.7 – 25
c. Etika akademike është e rëndësishme për suksesin akademik. 8	.4 – 5	15.8 - 10	<b>42.1 - 37.5</b>	<b>31.6 - 47.5</b>
ç. Integriteti akademik është një vlerë bazë e karrierës profesionale.	5.3 - 2.5	20 - 17.5	37.9 - 40	33.7 – 30
d. Kopjimi është një formë e pandershmërisë akademike.	<b>13.7 – 15</b>	21.1 - 35	<b>22.1 - 17</b>	<b>41.1 – 30</b>
dh. Plagjiatura është përvetësimi ose përdorimi i ideve, pronës intelektuale, apo punës së të tjerëve, në mënyrë të shkruar apo në mënyra të tjera, pa njoftimin dhe aprovimin e autorit.	<b>15.8 - 7.5</b>	13.7 - 20	<b>32.6 - 35</b>	<b>27.4 – 35</b>
e. Falsifikimi i gjetjeve të kërkimit është një formë e pandershmërisë akademike.	<b>16.8 – 15</b>	13.7 - 10	<b>27.4 - 30</b>	<b>40 – 45</b>
f. Kopjimi nuk dëmton askënd.	36.8 - 42.5	24.2 - 40	<b>22.1 - 10</b>	<b>12.6 - 2.5</b>
g. Dhënia e kopjes për një shok është një ndihmë për të.	27.4 – 20	27.4 - 47.5	<b>24.2 - 27.5</b>	<b>15.8 - 2.5</b>
h. Përderisa pandershmëria akademike nuk ndëshkohet, ajo nuk përbën një problem.	44.2 – 40	23.2 - 30	<b>16.8 – 20</b>	<b>13.7 - 7.5</b>

Nëse i referohemi tabelës më sipër, vihet re që në lidhje me perceptimin e studentëve mbi disa nga pohimet në lidhje me integritetin akademik dhe etikën akademike, mbizotëron një perceptim që i njej vlerat e integritetit dhe etikës akademike si bazë për sukses profesional dhe arritje akademike.

Ndërsa në grupin e dytë të pohimeve që fokusohen te disa nga format e mashtrimit, siç është: plagjiatura, kopjimi dhe falsifikimi i gjetjeve të kërkimit, perceptimi i studentëve tregon që këto forma të mashtrimit shikohen nga studentët si të tilla. Mirëpo ka një përqindje të studentëve të pyetur, rreth 15%, që nuk i shikojnë si pjesë të mashtrimit akademik.

Interesante janë gjetjet mbi fenomenin e kopjimit si formë të pandershmërisë akademike që vlerësohet nga studentët si ndihmë për moshatarët dhe nuk e shikojnë si të dëmshëm.

- Kopjimi nuk dëmton askënd:  
dakord 22.1% - 10% shumë dakord 12.6% - 2.5%.
- Dhënia e kopjes për një shok është një ndihmë për të:  
dakord 24.2% - 27.5% shumë dakord 15.8% - 2.5%.
- Përderisa pandershmëria akademike nuk ndëshkohet, ajo nuk përbën një problem:  
dakord 16.8% - 20% shumë dakord 13% - 7.5%.

Pasi identifikohen format e gabuara të perceptimit mbi disa forma të mashtrimit akademik, ndër to kopjimi në provime, i rëndësishëm është se si punohet me studentët për të korrigjuar shfaqjen e këtyre sjelljeve.

Studentët në përgjithësi vlerësojnë instruktorët të cilët mund të monitorojnë në mënyrë efektive të mësuarit në klasë dhe të sigurojë një nivel të përshtatshëm të ashpërsisë, sipas Barnas (2000). Menaxhimi i dobët në auditor nga pedagogu mund të ketë ulur poshtë muret për studentët që të angazhohen në mashtrim (7). Trost (2009) thekson se studentët duan që fakulteti të tregojë respekt për përpjekjet e të gjithë studentëve, duke mos toleruar asnjë formë të mashtrimit, duke përfshirë plagjiaturën, formën më të zakonshme të mashtrimit në arsimin e lartë (8).

Ndonëse është paaftësia e studentit në një lëndë të caktuar që i jep atij zgjidhje tjetër për të kryer një akt të mashtrimit. Aftësitë e varfra njohëse dhe të të kuptuarit e bëjnë një student të mbetet shumë prapa nga të tjerët. Si pasojë, ky student mashtron dhe bën plagjiaturë, pasi nuk vepron në përputhje me standardet e klasës. Pavarësisht vështirësive që ka në të kuptuarit e mësimit, zhvillimin e zakoneve të mira të studimit, ai ende arrin të fitojë besimin me nota të ngritura nga mënyra jo të ndershme (7).

Formimi akademik i studentëve nën ndikimin e sjelljeve të pandershme

Profesor Donald McCabe nga Rutgers University, themelues i Qendrës për Integritet Akademik, ka gjetur se më shumë se 75 për qind e studentëve të universitetit mashtrojnë të paktën një herë gjatë karrierës së tyre universitare (9).

Megjithatë, Whitley dhe kolegët e tij në një meta-analizë të ndjekur është fokusuar vetëm në dallimet gjinore, duke gjetur se studentët femra demonstuan veçanërisht qëndrime shumë negative ndaj mashtrimit në krahasim me studentët meshkuj, edhe pse raportimet mbi frekuencat për sjelljen e mashtrimit për të dy gjinitë kanë qenë pothuajse të njëjta (10). Wryobeck dhe Whitley (1999) shqyrtuan perceptimet e bashkëmoshatarëve të mashtruesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, duke gjetur se studentët me një orientim të lartë drejt të mësuarit rekomandojnë një dënim më të rëndë, ndërsa studentët me një orientim të lartë drejt notave të ish-in më të prirur të imitonin veprimet e mashtrueseve dhe të pranonin veprimet e tyre (10).

Në një kulturë ideale të integritetit dhe përgjegjësisë, fakulteti dhe administratorët angazhojnë studentët në një dialog të vazhdueshëm për integritetin akademik, që fillon me seanca orientuese dhe vazhdon në të gjithë programin. Përpjekje të tilla krijojnë pritshmëri për fakultetet, administratorët dhe studentët, të cilët kërkojnë që t'i sjellin të gjithë së bashku në një komunitet të besimit. Zhvillimi i një komuniteti etik ndodh jashtë klasës aq sa brenda saj, dhe kështu përfshin krijimin e një “kurrikulumi të fshehur” në të cilin studentët janë të angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e aftësive morale përmes arsytimit dhe diskutimit të rregullt, për të lehtësuar dilema të jetës reale etike që ata përballen në kontekstin e programit të edukimit të tyre (1).

### **Format e mashtrimit në të cilën përfshihen studentët**

Studentët përfshihen në disa forma të mashtrimit akademik. Për të zbuluar së në cilën prej këtyre formave është prevalenca më e lartë, kemi evidentuar frekuencën në përqindje të secilës sjelljeje mashtruese të përfshirë në pyetësor.

Te tabela më poshtë paraqiten në përqindje shpeshësia e sjelljeve sipas perceptimit të vetë studentëve të dy universiteteve private të përfshira në këtë punim.

**Tabela 2. Sa shpesh praktikohen këto forma dhe përdoren këto mjete të pandershmerisë akademike në AU dhe UET ?**

Forma dhe mjete AU/ UET	Kurrë R	rallë	Shpesh	Shumë shpesh
a. Kopjimi nga shoku	28.4 - 10 %	48.4 - 47.5%	<b>11.6 - 27.5%</b>	<b>19.5 - 15%</b>
b. Kopjimi nga libri	28.4 - 22.5	46.3 - 52.5	<b>15.8 - 15.4</b>	<b>.2 - 7.5</b>
c. Kopjimi nga internet	32.6 - 20.3	4.7 - 40	<b>23.2 - 25.5</b>	<b>.3 - 15</b>
ç. Kryerja e punimit nga një person tjetër	<b>44.2 - 35</b>	33.7 - 50	<b>16.8 - 7.5</b>	<b>2.1 - 7.5</b>
d. Kryerja e provimit nga një person tjetër	<b>60 - 62.5</b>	22.1 - 25	<b>8.4 - 5.3</b>	<b>.2 - 5</b>
dh. Autoplajgjiatura	41.1 - 42.5	29.5 - 30	13.7 - 22.5	3.2 - 2.5
e. Moscitimi	42.1 - 32.5	30.5 - 32.5	14.7 - 22.5	5.3 - 12.5
f. Përdorimi i telefonit	31.6 - 25	32.6 - 25	<b>21.1 - 25</b>	<b>12.6 - 20</b>
g. Përdorimi i kufjeve	<b>48.4 - 52.5</b>	24.2 - 20	<b>13.7 - 17.5</b>	<b>7.4 - 7.5</b>
gj. Përdorimi i fletushkave	33.7 - 32.5	35.8 - 27.5	<b>14.7 - 20</b>	<b>10.5 - 17.5</b>
h. Plagjiaturë e plotë	<b>47.4 - 50</b>	24.2 - 32.5	<b>15.8 - 10.5</b>	<b>.3 - 5</b>
i. Plagjiaturë e pjeseshme	38.9 - 32.5	28.4 - 47.5	<b>21.1 - 10</b>	<b>5.3 - 7.5</b>

AU – UET

AU - UET

Kopjimi nga interneti	- shpesh <b>23.2% – 25%</b>	shumë shpesh <b>5.3% – 15%</b>
Përdorimi i telefonit	- shpesh <b>21.1% – 25%</b>	shumë shpesh <b>12.6% – 20%</b>
Plagjiaturë e pjeseshme	- shpesh <b>21.1% – 10%</b>	shumë shpesh <b>5.3% – 7.5%</b>
Kryerja e punimit nga një person tjetër	- shpesh <b>16.8% – 7.5%</b>	shumë shpesh <b>2.1% – 7.5%</b>

Format e mësipërme janë ato që kanë shpeshësinë më të madhe, sipas studentëve të dy universiteteve. Ajo që vihet re, është që mbizotërojnë format e reja të mashtrimit, të ndihmuara nga avancimi teknologjik. Ndonëse përqindja më e madhe e studentëve, rreth 30 deri 40 për qind, theksojnë që ato nuk ndodhin kurrë. Gjithsesi, rreth 30 % e tyre shprehen se këto forma shfaqen shpesh dhe shumë shpesh. Ka ndryshim nga universitetet publike, ku vazhdonin të mbizotëronin format tradicionale të mashtrimit, si: kopjimi nga shoku dhe libri. Meqenëse janë marrë në konsideratë universitetet private, mund të arrihet në përfundimin që lehtësirat dhe kushtet më të mira në aspektin teknologjik - infrastrukturor të tyre mundësojnë shpeshësinë e këtyre sjelljeve.

Nëse i referohemi aspektit teorik që ofron literatura, duke cituar (Michaels & Miethe, 1989, Perry et al., 1990, si dhe Concoran 1987, Covey et al., 1989), theksohet se prevalenca e mashtrimit në detyrat e kursit mund t'i atribuohet mundësive të zgjeruara të ofruara nga rrethanat dhe larmisë së mbikëqyrjes nga ana e lektorit (7). Studentët mund të bëjnë lirisht çfarë të duan me detyrat e tyre të caktuara, pa frikën se do të kapen. Është e qartë se mashtrimi ka pasoja të mira, të paktën përkohësisht, për studentët të cilët mashtrojnë apo bëjnë plagjiaturë. Studenti ndoshta merr një rezultat të mirë në testin ose një shkallë më të lartë në shqyrtim se sa do të kishte qenë rasti pa mashtrim (13).

Plagjiatura është zakonisht një aktivitet privat që është më i motivuar individualisht se nga situatat motivuese (Rettinger & Kramer 2009). Pra, ajo mund të jetë më shumë socialisht e dënuar se mashtrimi në teste. Rezultatet treguan se shumica e studentëve mendojnë se kopjimi në një test është më tepër i pranuar nga shoqëria (11).

Në një studim theksohet se të anketuarit në të gjitha nivelet pohuan se shumica e plagjiaturës së studentëve është e rastësishme (12). Ka studiues të cilët sugjerojnë se plagjiatura nuk është mashtrim në përgjithësi, ashtu siç nuk është gjithmonë një sjellje e qëllimshme (5). Në këtë rast, ne i referohemi plagjiaturës së qëllimshme. Lidhur me këtë situatë, ka patur një pranim të qartë në lidhje me nevojën për të zhvilluar aftësitë e të shkruarit akademik, të nxitet sjellja e mirë akademike, praktikimi dhe rrënjosja e vlerave etike. Ka pasur pikëpamje të ndryshme të zhvillimit dhe trajnimit që ofrohet në kuadër të institucioneve dhe çfarë mund të bëhet më tepër, për shembull, disa mësues në Gjermani kanë shprehur mosbesim në idenë se profesorët kanë nevojë për ndonjë trajnim të mëtejshëm. Disa të anketuar thanë se ata tashmë u japin studentëve dhe zhvillimit të stafit seanca me cilësi të lartë në këtë fushë (12). Zhvillohen programe për të nxitur integritetin akademik në mesin e të gjithave segmenteve dhe komunitetit në kampuset universitare. Këto programe duhet të shkojnë përtej refuzimit të pandershmërisë akademike dhe duhet të përfshijnë diskutime në lidhje me rëndësinë e integritetit akademik dhe lidhjen e saj me çështjet më të gjera etike. Të jenë vigjilent për tendencat në arsimin e lartë dhe të teknologjisë, që ndikojnë në efektivitetin e politikave dhe procedurave të saj dhe të marrin hapa për të përmirësuar rinovimin e tyre (9).

Kibler (1993) vuri në dukje katër strategji që institucionet mund të adoptojnë për të ndihmuar fakultetin për të zbatuar integritetin akademik dhe për të parandaluar pandershmërinë akademike. Së pari, për të ndihmuar fakultetin, ndërsa ata janë duke administruar provime në klasa të mëdha. Së dyti, ata duhet të pajisen me shërbime të konsultimit, kur ndodhin shkelje të integritetit akademik. Së treti, përvojat e anëtarëve të fakultetit duhet të shpërndahen në çdo departament për të ofruar ndihmë për kolegët e tjerë. Së fundi, institucioni duhet të sigurojë njohje të anëtarëve të fakultetit të cilët trajtojnë saktë raste të mashtrimit akademik (5).

### Përfundime

Në përfundim të këtij punimi mund të arrij në përfundimin që fenomeni i pandershmërisë akademike është i pranishëm edhe tek universitetet private. Gjatë analizës së gjetjeve mbi perceptimin e studentëve, rezultoi se ata i njohin vlerat e integritetit dhe të etikës akademike si bazë për sukses profesional dhe arritje akademike. Interesante janë gjetjet mbi fenomenin e kopjimit si formë të pandershmërisë akademike që vlerësohet nga studentët si ndihmë për moshatarët dhe nuk e shikojnë si të dëmshëm. Ka ndryshim nga universitetet publike, ku mbizotërojnë format tradicionale të mashtrimit, si: kopjimi nga shoku dhe libri. Në universitetet private theksohen format e reja të mashtrimit përmes telefonit, internetit, plagjiatura etj. Arrihet në përfundimin që lehtësirat dhe kushtet më të mira teknologjike - infrastrukurore të universiteteve u mundësojnë studentëve shpeshtësinë e këtyre sjelljeve.

### Referenca

1. Mc Cabe, Donald and Keneth D. Butterfield. *Academic dishonesty in graduate business programs: Prevalence, causes and proposed action*. Academy of Management Learning & Education. 2006; Vol. 5, No. 3, p. 302.
2. Thompson, M. Melody & Wrigglesworth W, Jonathan J. (2012). Students and Teachers as Ethical Actors from: Handbook of Distance Education Routledge, p. 405.
3. Middleton, M. *An examination of Academic Dishonesty in Secondary Online English education*. A thesis submitted in the College of Education at the University of Central Florida, Orlando, 2012, p. 5.
4. Boehm, Pamela J. & Madelin Justice. *Promoting academic integrity in higher education*. The Community College Enterprise. 2009; p. 46.
5. Waithaka, G. Abel & Priscilla Gitimu. *Academic dishonesty: Team effort against it; a review of literature*. Journal of Academic and Business Ethics. Liberty University. 2012; Vol 6, p. 2, 4.

6. Gillespie, A. K. *The frequency and perceptions of academic dishonesty among graduate students*. A Research Paper Submitted for the Master of Science School Psychology. University of Wisconsin-Stout, 2003, p. 38.
7. Balbulena, E. Sh. and Lamela, A. L. *Prevalence, Motives, and Views of Academic Dishonesty in Higher Education*. Asia Pacific Journal of Multidisciplinary Research. 2015; Vol. 3, No. 2, p. 71-73.
8. Fish, Reva & Gerry Hura. *Students' perceptions of plagiarism*. Journal of the Scholarship of Teaching and Learning. 2013; Vol. 13, No. 5, p. 33.
9. The center for Academic Integrity. *The fundamental values of academic Integrity*. Duke University Durham, North Carolina; 1999, p. 1, 11.
10. Etter, Stephanie & Jackie J. Cramer. et al., *Origins of academic dishonesty: Ethical Orientation and Personality factors associated with attitudes about cheating with information technology*. Journal of Research on Technology in Education. 2006; p. 134, 135.
11. Miranda, M. S. *Academic dishonesty- Understanding how undergraduate students think and act*, ISATT, Paper published in Conference, University of Minho, Braga, Portugal. 2011; p. 11.
12. Glendinning, I. *Responses to student plagiarism in higher education across Europe*; Coventry University. UK International Journal for Educational Integrity. 2014; Vol. 10, No. 1, p.11 .
13. Colnerud, G and Rosander, M. *Academic dishonesty, ethical norms and learning, Assessment and evaluation in higher education*. Linköping University Electronic Press. 2009; 10, 16.